

Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

Raporti 02/2006 i Shtyllës së III-të (OSBE) Mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës 8 prill 2006 – 19 maj 2006

Titujt kryesor

- Kuvendi diskuton për zbatimin e Standardeve dhe privatizimin në Kosovë
- Kuvendi diskuton për situatën në Universitet, por nuk e cakton datën për debatin lidhur me arsimin
- Procedura për caktimin e rendit të ditës përsëri problematike
- Anëtarët e Këshillit të KPM-së gabimisht shpallen jo të ratifikuar, procesverbali përmirësohet në seancën plenare të radhës
- Ministri për Transport dhe Telekomunikacion paraqitet për interpelancë lidhur me rrugët në Kosovë
- Grupi për Integrim ende nuk është përfshirë në komisionet funksionale të Kuvendit

1. Sfond

Raporti i dyzetepestë i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së tretë të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej 26 nëntor 2002 dhe bazohet në pajtueshmërinë me Rregulloren e re të punës të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005.

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi ka mbajtur tri seanca plenare, më 20-21 prill, 27 prill, dhe 11 maj, dhe një seancë të jashtëzakonshme më 12/15 maj, si dhe tri mbledhje të rregullta të Kryesisë, më 11 prill, 19 prill, dhe 4 maj. Të dhjetë komisionet dhe nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, peticione dhe ankesa publike i kanë mbajtur mbledhjet gjatë kësaj periudhe.¹ Shtylla e III-të (OSBE) i ka monitoruar seancat plenare dhe mbledhjet e Kryesisë, si dhe 28 prej 31 mbledhjeve të komisioneve, një mbledhje të nënkomisionit, një mbledhje të komisionit ad-hoc për media dhe tri dëgjime publike.²

¹ Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese është takuar më 18 prill dhe 8 maj derisa Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media është takuar më 3 maj. Komisioni për buxhet dhe financa është takuar më 18 dhe 26 prill dhe 8 e 18 maj derisa Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve është takuar më 18 prill, 2, 8 dhe 19 maj. Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe persona të zhdukur është takuar më 11 dhe 19 prill, 4, 5, 16, 17 dhe 19 maj derisa Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport është takuar më 12 dhe 19 prill e 8 maj. Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet euroatlantike është takuar më 2 maj derisa Komisioni për gatishmëri emergjente është takuar më 5 maj. Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësor është takuar më 11 dhe 25 prill dhe 2 e 16 maj derisa Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion është takuar më 18 dhe 25 prill dhe 3 e 16 maj. Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione e ankesa publike është takuar më 19 prill dhe 10 maj. Komisioni Ad-hoc për media është takuar më 11 dhe 14 prill. Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion ka mbajtur dëgjimin publik të projektligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor më 10 prill. Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport ka mbajtur dëgjimin publik të projektligjit për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik më 12 prill. Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese ka mbajtur dëgjimin publik të projektligjit për ditën e dëshmorëve më 25 prill.

² Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese më 18 prill dhe 8 maj; Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media më 3 maj; Komisioni për buxhet dhe financa më 18 dhe 26 prill dhe 8 e 18 maj; Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim më 18 prill, 2, 8 dhe 19 maj; Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe persona të zhdukur më 11 dhe 19 prill, 4, 5, 16, 17 e 19 maj; Komisioni për arsim, shkencë,

2. Vështrim

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 20-21 prill e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe bashkëkryesoi deri në pauzë anëtari i Kryesisë z. Gazmend Muhaxheri (ORA), ndërsa pas pauzës z. Xhavit Haliti më 20 dhe 21 prill.

- Tetëdhjetë e shtatë dhe 82 deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 20, përkatësisht 21 prillit.³
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 20-21 prillit:
 - Shqyrtimi i zbatimit të Standardeve për Kosovën (Kryeministri Agim Çeku (AAK) ka bërë prezantimin, pas të cilit ka pasuar debati dhe përgjigjet nga Kryeministri dhe ministrat tjerë të pranishëm.)
 - Shqyrtimi i procesit të privatizimit në Kosovë (Shefi i Shtyllës së IV-të të UNMIK-ut Joachim Ruecker dhe Ministri për Tregti dhe Industri Bujar Dugolli (AAK) bënë prezantime, pas të cilëve ka pasuar debati dhe përgjigja nga Ministri për Tregti dhe Industri.)
 - Shqyrtimi i informatës për parandalimin e gripit të shpezëve (Kjo pikë e rendit të ditës ishte shtyrë për seancën plenare të radhës.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 27 prill e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe bashkëkryesoi anëtari i Kryesisë z. Sabri Hamiti (LDK).

- Shtatëdhjetë e nëntë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 27 prillit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 27 prillit:
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për auditimin e brendshëm (Projektligji është miratuar në parim me 62 vota për, një votë kundër dhe pa abstenime.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për arbitrazhin (Projektligji është miratuar në parim me 66 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për shëndetin riprodhues (Projektligji është miratuar në parim me 64 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i informatës për parandalimin e gripit të shpezëve (Ministri për Shëndetësi Sadik Idrizi (6+/Vakat) dhe Zëvendësministri për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural Tomë Hajdaraj (LDK) bënë prezantime, pas të cilëve ka pasuar debati dhe përgjigjet nga Ministri për Shëndetësi dhe Zëvendësministri për Bujqësi.)
 - Shqyrtimi i rekomandimeve për emërimin e katër anëtarëve nga shoqëria civile në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media. (Kandidatët morën 57 vota për, njëmbëdhjetë vota kundër dhe gjashtë abstenime, dhe janë shpallur si jo të ratifikuar. Shiko pikën e dytë nën “Procesi i votimit”).

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 11 maj e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe bashkëkryesoi anëtari i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Shtatëdhjetë e gjashtë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 11 majit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 11 majit:

teknologji, kulturë, rini dhe sport më 12 e 19 prill dhe 8 maj; Komisioni për gatishmëri emergjente më 5 maj; Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor më 11 prill dhe 16 maj; Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion më 18 dhe 25 prill dhe 3 e 16 maj; Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione e ankesa publike më 10 maj; Komisioni Ad Hoc për media më 14 prill; Dëgjimin publik të projektligjit për trafikun rrugor më 10 prill; dëgjimin publik të projektligjit për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik më 12 prill; dhe dëgjimin publik të projektligjit për ditën e dëshmorëve më 25 prill.

³ Përveç nëse është bërë e ditur në ndonjë mënyrë tjetër në këtë raport, kjo ishte shifra e njoftuar nga Kryetari i Kuvendit apo Kryesuesi në fillim të ditës.

- Shqyrtimi i parë i projektligjit për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore (Projektligji është miratuar në parim me 58 vota për dhe tetë vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për shëndetin publik (Projektligji është miratuar në parim me 69 vota për dhe tri vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për veprimtarinë hidrometeorologjike (Projektligji është miratuar në parim me 60 vota për dhe dhjetë vota kundër.)
- Interpelanca e Ministrit për Transport dhe Komunikacion Qemajl Ahmeti (LDK), propozuar nga grupi parlamentar i PDK-së, lidhur me gjendjen e rrugëve në Kosovë (Interpelanca është paraqitur nga shefi i grupit parlamentar të PDK-së z. Jakup Krasniqi, dhe më pas ka pasuar përgjigja e Ministrit Ahmeti, debati, përgjigjet përfundimtare të Ministrit Ahmeti, dhe konkluzioni i propozuar nga z. Jakup Krasniqi. Shiko “Interpelanca”.)

Seancën e jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 12/15 maj e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe bashkëkryesoi anëtari i Kryesisë z. Naim Maloku (AAK) më 12 maj. Seancën më 15 maj e kryesuan z. Sabri Hamiti (LDK) dhe z. Naim Maloku (AAK).

- Nëntëdhjetë dhe 65 deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 12, përkatësisht 15 majit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 12/15 majit:
 - Diskutimi i gjendjes së krijuar në Universitetin e Prishtinës (Përfaqësuesi i grupit parlamentar të PDK-së z. Enver Hoxhaj, si nismëtar i debatit, bëri deklaratën hyrëse, pas së cilës ka pasuar përgjigja e Ministrit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji Agim Veliu (LDK) dhe debati.)

3. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

Rendi i ditës

- Rendi i ditës i seancës së 20-21 prillit – diskutimi për zbatimin e standardeve dhe privatizimin – është miratuar nga Kuvendi në fund të seancës së 6 prillit, mirëpo një pikë shtesë e rendit të ditës – informata për parandalimin e gripit të shpezëve – është shfaqur në rendin e ditës kur u është shpërndarë më vonë deputetëve. Në fillim të seancës më 20 prill, znj. Teuta Hadri (PDK) deklaroi se informata e dorëzuar nga Qeveria lidhur me gripin e shpezëve nuk ishte e plotë, andaj propozoi që diskutimi të shtyhej. Disa deputetë nga grupe të ndryshme parlamentare propozuan pika për t’u diskutuar në seancat e ardhshme por u është thënë që t’i parashtrojnë propozimet me shkrim. Kryetari i Kuvendit e vëri në votim propozimin e znj. Hadri për shtyerjen e diskutimit të gripit të shpezëve, i cili ishte refuzuar me 62 kundër dhe 40 vota për. Megjithatë, kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë, më 21 prill, sepse diskutimet për zbatimin e Standardeve dhe privatizimin kanë zgjatur më tepër se sa ishte pritur. Në fund të diskutimit për privatizimin, Kryetari i Kuvendit lajmëroi se seanca do të vazhdonte më 27 prill me diskutimin për gripin e shpezëve. Seanca e mbajtur më 27 prill nuk ishte në të vërtetë vazhdim i seancës së 20-21 prillit, por ishte seancë në vete me rendin e ditës që përmbante diskutimin e gripit të shpezëve dhe disa pika të reja. Rendi i ditës nuk është paraqitur për miratim në Kuvend as në fund të seancës së 20-21 prillit as në fillim të seancës së 27 prillit. Rendi i ditës i seancës plenare të 11 majit është paraqitur për miratim në fillim të po kësaj seance. Shumica e deputetëve votoi për, por derisa ata po votonin, z. Emrush Xhemajli (LPK) e ngriti dorën për të intervenuar dhe propozoi që Kuvendi t’i shtonte rendit të asaj dite diskutimin e ndryshimeve që i ishin bërë Ligjit për të drejtat dhe statusin e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së, dhe viktimave civile të luftës⁴ nga UNMIK-u

⁴ Sipas rregullores (2006/29), emri zyrtar është “Ligji për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe anëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të konfliktit të armatosur në Kosovë”. Me qëllim të thjeshtësimit, dhe për shkak se përshkrimi reflekton diskutimin që është bërë në Kuvend, ky raport do t’i referohet

në rregulloren me të cilën ishte shpallur. Ai e shprehu indinjatën e tij për karakterin e ndryshimeve që ishin bërë pas miratimit të ligjit në Kuvend. Z. Ramë Buja (PDK) i përsëriti vërejtjet e z. Xhemajli duke pohuar se PSSP-ja do të duhej të kishte kërkuar që Kuvendi t'i bënte ndryshimet në ligj, e jo t'i bënte në mënyrë të njëanshme me rastin e shpalljes. Z. Buja deklaroi se, sipas ligjit në këtë formë pas shpalljes, në Kosovë “nuk paska pasur luftë, as heronj”. Ai propozoi që ligji të kthehet në Kuvend për shqyrtim të mëtutjeshëm; përndryshe “nuk mund të njihet si ligj i nxjerrë dhe i miratuar nga Parlamenti.” Kryetari i Kuvendit iu përgjigj të dyve, z. Xhemajli dhe z. Buja, se Kuvendi ende nuk e kishte marrë tekstin e ligjit pas shpalljes, por Kuvendi mund ta shqyrtojë atë pas marrjes së tekstit zyrtar. Z. Alush Gashi deklaroi se LDK-ja e mbështeste rendin e ditës ashtu siç ishte propozuar nga Kryesia, por kërkoi të dinte nëse Kryesia po planifikonte ta rikthente praktikën e propozimit të seancave një javë plenare më herët, ashtu siç kërkohet me Rregullore, me ç'rast pika e fundit e rendit të ditës të seancës në fjalë do të duhej të ishte “Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës.” Z. Gjergj Dedaj (Për Integrim/PLK) filloi të komentojë rreth një aspekti tjetër të Ligjit për të drejtat dhe statusin e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së, dhe viktimave civile të luftës, me të cilin ai nuk pajtohej. Kryetari i Kuvendit e informoi z. Dedaj se pika për të cilën po diskutonte ai nuk ishte në rendin e ditës atë ditë. Z. Dedaj tha se ai do të fliste lidhur me ligjin, pa marrë parasysh se a ishte apo jo në rendin e ditës, sepse ai e konsideronte si më të rëndësishëm se pikat tjera të rendit të ditës së asaj dite, dhe pohoi se Kryetari i Kuvendit nuk mund t'ia merrte fjalën sepse ai është deputet i zgjedhur i Kuvendit. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se, siç ishte thënë edhe më herët, Kuvendi do të diskutonte për fatin e këtij ligji pasi ta ketë marrë kopjen zyrtare nga UNMIK-u.

Znj. Gjylnaze Sylja (AAK) kërkoi që të veprohej në pajtim me rregullat 23 dhe 29 dhe tha se rendi i ditës i seancës plenare të radhës gjithmonë duhet të paraqitet për miratim *në fund të seancës paraprake*, dhe se çfarëdo pika urgjente për shqyrtim gjatë seancës së caktuar duhet të propozohen *vetëm me lejen paraprake të Kryetarit të Kuvendit*. Rendi i ditës i seancës së ardhshme nuk është paraqitur për miratim në fund të seancës plenare të 11 majit.⁵

Edhe pse praktika e përgatitjes dhe miratimit të rendeve të ditës është përmirësuar dukshëm gjatë muajve të kaluar⁶, duket se Kuvendi i është rikthyer praktikave të mëhershme. Rendi i ditës i seancës së 20-21 prillit është miratuar në seancën paraprake por një pikë ishte futur në ndërkohë. Rendi i ditës i seancës së 27 prillit nuk është paraqitur për miratim asnjëherë. Rendi i ditës i seancës së 11 majit është miratuar vetëm në fillim të seancës së njëjtë, ndërsa rendi i ditës së seancës së rregullt të radhës nuk është paraqitur për miratim në fund të seancës së 11 majit. Përgatitja dhe miratimi i rendeve të ditës gjatë periudhës raportuese ishte në kundërshtim me rregullën 23.1 e cila kërkon që rendi i ditës për cilëndo seancë plenare të propozohet nga një anëtar i Kryesisë dhe të miratohet nga Kuvendi në fund të seancës paraprake. “Në fund të çdo seance, Kryetari i Kuvendit, ose një anëtar tjetër i Kryesisë, propozon rendin e ditës të seancës së ardhshme. Propozimi konsiderohet i miratuar përveç nëse një ose më shumë grupe parlamentare ose . . . gjashtë deputetë e kundërshtojnë këtë.”

Rregulla 29.1 parasheh që “në çdo seancë plenare, deputeti në marrëveshje me Kryetarin e Kuvendit, mund të propozojë që Kuvendi të shqyrtojë menjëherë një çështje urgjente. Nëse Kryetari i Kuvendit konsideron se çështja menjëherë meriton t'i kushtohet vëmendja e Kuvendit, deputetit në fjalë i mundëson të japë propozime në Kuvend që pastaj do ta vënë në votim.” Sipas rregullës 29.1, vendimi nëse çështjet “urgjente” të propozuara “meritojnë vëmendjen e Kuvendit” i takon Kryetarit të Kuvendit.

Intervenimi i Kryetarit të Kuvendit gjatë fjalimit të z. Dedaj ishte në pajtim me rregullën 22.10 e cila e obligon Kryetarin e Kuvendit që t'ia tërheq vërejtjen secilit deputet të Kuvendit i cili

këtij ligji si Ligji për të drejtat dhe statusin e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së, dhe viktimave civile të luftës.

⁵ Seanca plenare e radhës mbajtur më 12 maj ishte seancë e jashtëzakonshme dhe rendi i saj i ditës është caktuar me procedurë të ndarë.

⁶ Shiko raportet 01/2006 dhe 02/2006 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës

“largohet nga çështja e parashtruar për diskutim” ose “në ngrit një çështje jashtë temës së debatit ose mocionit”.

- Në fillim të seancës plenare të 27 prillit, z. Enver Hoxhaj (PDK) e ngriti si çështje urgjente nxerrjen e Udhëzimit Administrativ një ditë më parë nga Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji mbi “rizgjedhjet e plota për ta përmbyllur rivendosjen e qeverisjes së ligjshme në Universitetin e Prishtinës”, duke theksuar se kjo i jep të drejtë Ministrit që t’i shkarkojë zyrtarët e lartë në rast të mospërputhjes me procedurat dhe afatet e këtij udhëzimi. Z. Hoxhaj kërkoi që kjo çështje t’i shtohet rendit të ditës të seancës në fjalë dhe që Ministri dhe Kryeministri të dalin para Kuvendit dhe ta arsyetojnë futjen e “masave të dhunshme” në Universitet. Znj. Gjylnaze Sylja (AAK) deklaroi se grupi i saj parlamentar ishte për atë që të mbahej diskutimi jo vetëm lidhur me ngjarjet e fundit në Universitet por lidhur me arsimin në përgjithësi, që do të kërkonte më shumë kohë për përgatitje. Znj. Teuta Sahatqija (ORA) e deklaroi mbështetjen e grupit të saj parlamentar për diskutimin lidhur me arsimin, duke thënë se ORA e kishte kërkuar një debat të tillë disa muaj më parë, dhe propozoi që shefat e grupeve parlamentare të takoheshin për të vendosur se a të mbahet debati si pikë e rendit të ditës së seancës në fjalë apo në një seancë të jashtëzakonshme plenare. Z. Alush Gashi (LDK) deklaroi se ishte për mbajtjen e diskutimit të përgatitur mirë për këtë çështje. Z. Ferid Agani (Për Integrim) e deklaroi mbështetjen e grupit të tij parlamentar për propozimin e PDK-së dhe e përsëriti propozimin e znj. Sahatqija për një takim të shkurtër të shefave të grupeve parlamentare. Kryesuesi nuk dha pushim për konsultim në mes të shefave të grupeve parlamentare, por e vëri në votim propozimin si çështje urgjente për shqyrtim në seancën plenare në fjalë. Propozimi është refuzuar me 47 vota kundër, 29 për dhe katër abstenime. Znj. Gjylnaze Sylja e përsëriti se AAK-ja ishte për mbajtjen e diskutimit të propozuar, por besonte se duhej më shumë kohë që të përgatitej debati në mënyrë të duhur. Më 3 maj, grupi parlamentar i PDK-së ka dorëzuar një kërkesë me shkrim për mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme “për ta debatuar çështjen e arsimit në Kosovë në përgjithësi, dhe Universitetin e Prishtinës në veçanti”, të nënshkruar nga 40 deputetë të PDK-së, ORA-s dhe Grupit për Integrim. Kryesia, në mbledhjen e saj të mbajtur më 4 maj, e ka shqyrtuar kërkesën, duke diskutuar shkurtimisht se a ishte e mundshme që të diskutoheshin të dyja çështjet në një seancë, dhe vendosi që të mbahet një seancë e jashtëzakonshme më 12/15 maj, por nuk mori vendim lidhur me kufizimin e pikave për diskutim. Rendi i ditës i seancës së 12/15 majit që u ishte shpërndarë më vonë deputetëve përfshinte vetëm “diskutimin e situatës në Universitetin e Prishtinës”. Seanca filloi me vërejtje nga ana e PDK-së ndaj faktit se rendi i ditës ishte kufizuar vetëm në diskutimin për Universitetin, duke rikujtuar se kishte kërkuar seancë të jashtëzakonshme për të dyja çështjet, Universitetin dhe arsimin në përgjithësi në Kosovë. Kryetari i Kuvendit dhe z. Naim Maloku (AAK) u përgjigjën se kërkesa vërtet ishte bërë për të dyja këto tema, por Kryesia kishte vendosur se ishte më e logjikshme që të ndahej kërkesa në dy pjesë dhe të trajtohej në dy seanca të ndara plenare, në mënyrë që çështja e Universitetit të trajtohej si urgjente dhe të lejohej kohë e mjaftueshme për t’u përgatitur për debatin më të gjerë për arsimin në Kosovë. Pas më shumë se një orë debatimi lidhur me rendin e ditës, me ç’rast PDK-ja pohonte se Kryesia nuk ka autorizim ta ndryshojë kërkesën për seancë të jashtëzakonshme plenare, dhe pas një pushimi për konsultim midis grupeve parlamentare, PDK-ja më në fund u pajtua që në atë seancë të debatohej vetëm për Universitetin me garancën se shumë shpejtë do të caktohej data e mbajtjes së seancës plenare lidhur me arsimin në Kosovë. Përkundër kërkesës së PDK-së, ORA-s dhe Grupit për Integrim, kjo datë nuk është caktuar në atë seancë.

Rregulla 23.5 parasheh se “Kryesia thërret, me nismën e vet, ose si përgjigje ndaj kërkesës së bërë nga kryeministri, nga një ose më shumë grupe parlamentare, që përfaqësojnë jo më pak se një të tretën, përkatësisht 40 deputetë në Kuvend, seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit, në mënyrë që ta trajtojë një çështje të ngutshme. Kërkesa duhet të përmbajë çështjen ose çështjet që do të shqyrtohen si dhe arsyet pse ato konsiderohen të ngutshme dhe të rëndësishme që edhe në mënyrë të tillë të shqyrtohen në Kuvend. Në raste të tilla shqyrtohen vetëm çështjet që përbëjnë bazën e kërkesës.” Rregullorja nuk i jep të drejtën Kryesisë që ta ndryshojë kërkesën,

por në këtë rast palët që kanë bërë kërkesën u pajtuan në fund që diskutimi i seancës plenare të 12/15 majit të kufizohet vetëm lidhur me Universitetin.

Debatet

- Në seancën plenare të 20 prillit, Kryeministri Agim Çeku bëri paraqitjen lidhur me zbatimin e Standardeve, pas së cilës ka pasuar debati që ka zgjatur për afërsisht gjashtë orë. Debati është zhvilluar sipas vijave tipike partiake, me ç'rast partitë e koalicionit e lavdëronin progresin që është arritur deri më tani në zbatimin e Standardeve, ndërsa partitë e opozitës, posaçërisht ata të PDK-së, e kritikonin Qeverinë për dështimin në zbatimin e Standardeve dhe e akuzonin për korrupsion. Të gjithë folësve që donin të flisnin më shumë se dhjetë minuta u është lejuar ta bëjnë këtë, e disa deputetë kanë folur gati 20 minuta, përkundër ndërhyrjeve të shumta nga ana e Kryetarit të Kuvendit. Në fund të debatit, Kryeministri Çeku i u përgjigj deklaratave që ishin bërë, me ç'rast e falënderoi Kuvendin për një debat kryesisht konstruktiv, por e shprehu edhe keqardhjen që “përsëri po përdoren ofendimet dhe akuza të paargumentuara - i njëjti fjalor që jemi duke e dëgjuar që nga dita e parë.” Sa u përket akuzave për korrupsion, Kryeministri e pranoi se sipas të gjitha gjasave në Qeveri ka korrupsion, por se ai do ta luftonte atë dhe shtoi se “korrupsioni nuk kishte filluar me këtë Qeveri.” Ai e përmbylli deklaratën e tij duke thënë se Qeveria e respektonte të drejtën e deputetëve të Kuvendit të bënin kritika por u kërkoi atyre që t'i mbështesnin ato me arsyetime. Z. Hajredin Kuçi (PDK) e mbrojti të drejtën e deputetëve që të bëjnë akuza duke pohuar se “me përjashtim të ngritjes së urrejtjes nacionale çdo diskutim tjetër kanë të drejtë ta bëjnë.” Z. Xhevat Bislimi (PDK) deklaroi se “humbja e durimit nga ana e Kryeministrit dhe përpjekja e tij që t'i kundërvihet Kuvendit, ta marrë në mbrojtje korrupsionin, krimin e organizuar dhe shkeljen e ligjeve është një provë se edhe ky Kryeministër do të dështojë si paraardhësit e tij. Unë me të vërtetë e shprehi keqardhjen se ai në vend se ta luftojë korrupsionin dhe krimin e organizuar, ai është bërë avokat i tyre.” Z. Gjylnaze Sylja (AAK) kërkoi nga Kryetari i Kuvendit që ta “ushtronte rregullën 22.10,” dispozitën lidhur me gjuhën joparlamentare.

Rregulla 22.7, parasheh që “Diskutimi në Kuvend nuk zgjat më shumë se 10 (dhjetë) minuta për secilin deputet të Kuvendit” nëse Kuvendi nuk vendos ndryshe. Sipas rregullës 22.9 Kryesuesi mund t'i lejojë deputetit të flasë më gjatë se koha e caktuar kur ai “konsideron se kjo është në të mirë të diskutimit.” Gjatë seancave të fundit, Kryetari i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë që kryesonin seancat plenare u kanë dhënë kohë shtesë folësve gati në të gjitha rastet kur kjo është kërkuar. Kryesuesit e seancave plenare do të mund të mbanin qëndrim më rreptë në kufizimin e deklaratave të deputetëve të Kuvendit në pajtim me kohën e përcaktuar me rregullore.

Rregulla 22.10 parasheh se deputetët e Kuvendit nuk duhet të përdorin gjuhën joparlamentare që definohet se “është ofenduese, shpifëse, apo kërcënuese; sulme ose fyerje personale; gjuhë e pahijshme; apo nxit dhunë ndëretnike,” definicion shumë më i gjërë se ai i ofruar nga z. Kuçi gjatë debatit. Rregulla 22.11 parasheh që “Kryetari i Kuvendit mund ta urdhërojë një deputet ose ministër, që sipas mendimit të tij ka përdorur gjuhë jo parlamentare, t'i tërheq fjalët e tilla, ose nëse do të jetë e nevojshme merr masa në pajtim me paragrafin 13 të kësaj rregulle.”⁷ Është nën autoritetin e kryesuesit të seancës që të përcaktojë nëse një deklaratë e caktuar duhet të konsiderohet si “gjuhë joparlamentare” dhe të kërkojë nga deputeti t'i “tërheq” ato fjalë.

- Gjatë diskutimit për parandalimin e gripit të shpezëve në Kosovë, z. Xhevat Bislimi (PDK) deklaroi se Kuvendi do të duhej të ndërmerre masa për ta luftuar një virus tjetër – korrupsionin – dhe ta fuste Qeverinë në karantinë. Kryetari i Kuvendit kërkoi nga ai që t'i përmbahej temës së diskutimit, me ç'rast z. Bislimi e përfundoi deklaratën e tij.
Ndërhyrja e Kryetarit të Kuvendit gjatë fjalimit të z. Bislimi ishte në pajtim me rregullën 22.10 e cila e obligon Kryetarin e Kuvendit që të kërkojë nga secili deputet i Kuvendit i cili “largohet nga çështja e parashtruar për diskutim” ose “ngrit një çështje jashtë temës së debatit ose mocionit” t'i përmbahet rendit.

⁷ Në rregullën 22.13 shkruan: “Në rast të ndonjë parregullsie serioze në Kuvend, Kryetari i Kuvendit mund ta shtyjë seancën në tërësi, ose mund të pezullojë për një kohë të caktuar.”

Shpërndarja e dokumentave

- Projektligji për auditimin e brendshëm është shpërndarë më 28 mars, projektligji për arbitrazhin është shpërndarë më 30 mars dhe projektligji për shëndetin riprodhues është shpërndarë më 6 prill. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 20, 18, përkatësisht 13 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 27 prill. Projektligji për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore është shpërndarë më 7 prill, projektligji për shëndetin publik është shpërndarë më 10 prill dhe projektligji për veprimtarinë hidrometeorologjike është shpërndarë më 25 prill. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 21, 18, përkatësisht dhjetë ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 11 maj.

Rregulla 35.1, parasheh që shqyrtimi i parë i projektligjit të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes së tij. Shumë projektligje gjatë periudhës raportuese janë shqyrtuar për të parën herë pas më shumë se tri javësh nga data e shpërndarjes së tyre. Kuvendi edhe më tej vazhdon të ketë disa vështirësi në shqyrtimin e projektligjeve në pajtim me afatin e përcaktuar në Rregulloren e punës edhe përkundër faktit se ka filluar t'i mbajë seancat plenare më shpesh. Megjithatë, disa nga seancat plenare i kushtohen vetëm diskutimit të çështjeve aktuale të rëndësishme e jo shqyrtimit të projektligjeve.

Procesi i votimit

- Kishte kuorum për të gjitha votimet në seancat plenare në fjalë.
Kjo është në pajtim me nenin 9.1.32 të Kornizës Kushtetuese dhe rregullën 31.1, e cila parasheh që për marrjen e vendimeve duhet të jenë të pranishëm shumica e deputetëve.

- Në seancën plenare të 27 prillit, Kuvendi i ka votuar katër kandidatë nga shoqëria civile për Këshillin e KPM-së të propozuar nga komisioni ad-hoc për media. Para se të fillonte votimi, kryesuesi i komisionit ad-hoc z. Sabri Hamiti (LDK) i paraqiti propozimet dhe deklaroi se komisioni ad-hoc ishte takuar më 11 dhe 14 prill dhe kishte përzgjedhur katër nga tetë kandidatë, me votim të fshehtë, dhe se grupi i katër kandidatëve ishte i balancuar në aspektin gjinor dhe etnik. Z. Hamiti e informoi Kuvendin se sipas Ligjit për komisionin e pavarur të mediave dhe transmetimin (Ligji për KPM-në), lista e kandidatëve duhej të merrte “së paku 50% të votave të Kuvendit”. Lista e kandidatëve më pas është vënë në votim dhe ka marrë 57 vota për, njëmbëdhjetë vota kundër dhe gjashtë abstenime. Kandidatët u shpallën si jo të ratifikuar meqë kishin marrë më pak se 61 vota për. Z. Hamiti komentoi se ata të cilët kishin votuar kundër kishin gabuar dhe se në atë mënyrë ia kishin zgjatur mandatin Komisionerit të përkohshëm të mediave. Kryesia, në mbledhjen e saj më 4 maj, e ka shqyrtuar shkurtimisht memorandumun e Departamentit për mbështetje ligjore dhe procedurale, në të cilin thuhej se Ligji për KPM-në ishte interpretuar gabimisht në seancën plenare të 27 prillit dhe se për ratifikimin e kandidatëve për Këshillin e KPM-së nevojitet vetëm shumica e thjeshtë e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Në fillim të seancës plenare më 11 maj, Kryetari i Kuvendit e informoi Kuvendin se kandidatët e propozuar për Këshillin e KPM-së në të vërtetë janë ratifikuar sipas ligjit kur kanë marrë 57 vota në seancën paraprake plenare dhe Kuvendi më pas votoi për përmirësimin e procesverbalit të seancës plenare të 27 prillit për ta pasqyruar këtë fakt.

Sipas nenit 4.4 (g) të Ligjit për KPM-në Kuvendi duhet të vërtetojë “formalisht” emërimin e anëtarëve të Këshillit nga shoqëria civile. Ligji nuk parasheh në këtë rast kusht të posaçëm për votim; andaj për ratifikimin e kandidatëve të propozuar kërkohej vetëm “shumica e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë” (neni 9.1.33 i Kornizës Kushtetuese, dhe rregulla 31.1). Kandidatët janë shpallur gabimisht si jo të ratifikuar në seancën plenare të 27 prillit, sepse si bazë për përcaktimin e votave të nevojshme është marrë neni 4.3 (c) në vend të nenit 4.4 (g). Versioni në shqip i nenit 4.3 (c), i cili nuk i atribuohet katër anëtarëve nga shoqëria civile të propozuar nga komisioni ad-hoc, por vetëm anëtarit i cili emërohet drejtpërdrejt nga Kuvendi, parasheh se anëtari duhet ta ketë përkrahjen e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit (së paku 61 vota) për t’u konsideruar i emëruar. Versioni në anglisht i nenit 4.3 (c), i cili

mbizotëron në raste të tilla të mospërputhjes, parasheh se anëtarit të Këshillit të KPM-së që emërohet drejtpërdrejt nga Kuvendi, i nevojitet vetëm përkrahja e “shumicës së deputetëve të pranishëm”. Është e nevojshme që kjo të mirret parasysht me rastin e emërimit të anëtarit të pestë për Këshillin e KPM-së.

Pyetjet për Qeverinë

- Në fillim të seancës plenare të 27 prillit, z. Hydajet Hyseni (PDK) deklaroi se nuk do të heqte dorë nga pyetja që ai kishte dorëzuar Qeverisë disa muaj më herët lidhur me personat e zhvendosur nga lugina e Preshevës, si dhe për fatin e pesë milion eurove të ndara nga Qeveria me rekomandim të Kuvendit, dhe insistoi se duhej të merrte përgjigje. Kryesuesi u përgjigj se “pyetjet kishin hyrë në procedurë parlamentare” dhe se nuk mund të thuhej asgjë më shumë përveç se është detyrë e Ministrave që të përgjigjen në pyetjet parlamentare. Z. Hyseni e ka ngritur këtë çështje edhe një herë më herët në seancën plenare të 11 majit, por nuk ka marrë përgjigje.

Z. Hyseni së pari e përmendi pyetjen e mbetur pa përgjigje gjatë seancës së 15/16/19 dhjetorit, me ç’rast ka deklaruar se e kishte dorëzuar pyetjen tre muaj më parë.⁸ Sipas rregullave 26-27, pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë do të vendosen në rendin e ditës në njërën nga seancat e radhës menjëherë pasi të jetë dorëzuar pyetja, ndërsa pyetjet për Qeverinë për përgjigje me shkrim do të përgjigjen brenda dy javësh pas dorëzimit dhe “futen në procesverbalin e punimeve të Kuvendit për ditën kur është dhënë përgjigja ose për ditën e parë pas saj, kur Kuvendi mbledhet në seancë plenare.” Të njëjtat rregulla kërkojnë që pyetjet për Qeverinë që nuk marrin përgjigje me shkrim brenda afatit (rregulla 27) ose që refuzohen brenda Kuvendit për shkak se nuk janë në pajtim me rregulloren e Kuvendit (regulla 26.5) “të publikohen në buletinin e Kuvendit.” Buletini i Kuvendit të Kosovës nuk përmban pjesë për pyetjet që i janë dorëzuar Qeverisë. Z. Hyseni e ka ngritur çështjen e pyetjeve që nuk janë përgjigjur nga Qeveria disa herë që kur e ka dorëzuar pyetjen e tij më shumë se tetë muaj më parë, por nuk ka marrë njoftim nga udhëheqësia Kuvendit nëse kjo çështje është ndjekur më tej në Qeveri. Udhëheqësia e Kuvendit do të duhej të hetonte në Qeveri lidhur me statusin e pyetjeve parlamentare dhe të sigurojë që ato të marrin përgjigje me kohë.

Interpelanca

- Në fund të seancës plenare të 11 prillit, z. Jakup Krasniqi (PDK) e ka paraqitur interpelancën e PDK-së drejtuar Ministrin të Transportit dhe Komunikacionit Qemajl Ahmeti (LDK), duke shtruar në të njëjtën kohë një sërë pyetjesh të detajuara lidhur me ato të parashtruara në interpelancë dhe e shprehu pakënaqësinë e tij në përgjigjen me shkrim që e kishte dërguar Ministri. Ministri Ahmeti iu drejtua Kuvendit duke iu përgjigjur pyetjeve dhe më pas Kryetari i Kuvendit e hapi debatin lidhur me interpelancën. Diskutimi ishte mjaft i gjerë dhe i mbizotëruar nga deputetët e opozitës, por edhe përfaqësuesit e koalicionit qeverisës gjithashtu bënë komente ose pyetje shtesë lidhur me temën e shtruar. Kah fundi i diskutimit, z. Sabri Hamiti (LDK) komentoi se interpelanca kishte zgjatur së tepërmi. Kryesuesi⁹ u përgjigj se secili deputet i Kuvendit e ka të drejtën për të folur 10 minuta. Pasi që të gjithë deputetët që kishin dëshiruar të flisnin e kishin bërë këtë, Kryesuesi e informoi Ministrin Ahmeti se ai mund të fliste për aq kohë sa e shihte të nevojshme për t’iu përgjigjur pyetjeve. Ministri Ahmeti ka folur për afërsisht 25 minuta, duke iu përgjigjur shumicës së pyetjeve që ishin shtruar. Z. Jakup Krasniqi më pas e përmbylli debatin me një numër komentesh dhe një konkluzion të propozuar për formimin e një komisioni hetimor, i cili do ta shqyrtonte “humbjen” e 6.9 milion eurove nga Ministria për Buxhet, duke u thirrur në një deklaratë të bërë më herët gjatë debatit nga Ministri. Ministri Ahmeti u përgjigj duke thënë se kishte ndodhur një keqkuptim – nuk kishte qenë qëllimi i tij që të linte të kuptohej se paratë kishin “humbur” por se kjo shumë ishte derdhur drejtpërdrejt në

⁸ Shiko fusnotën 20 të raportit 10/2005 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës

⁹ Z. Xhavit Haliti e mori kryesimin e seancës plenare nga Kryetari i Kuvendit gjatë debatit të interpelancës.

buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2005 në vend se në buxhetin e MTT-së. Andaj, konkluzioni i propozuar nuk është vënë në votim dhe seanca plenare përfundoi.

Debati i interpelancës është bërë në pajtim me dispozitat përkatëse¹⁰ të rregullës 25 dhe rregullës 22.7 (“Diskutimi në Kuvend nuk zgjat më shumë se 10 (dhjetë) minuta për secilin deputet të Kuvendit, nëse Kuvendi nuk vendos ndryshe.”). Sipas rregullës 22.9, është në autoritetin e Kryesuesit që t’i lejojë Ministrit të përgjigjet më gjatë se dhjetë minuta pyetjeve të shumta të deputetëve të Kuvendit, meqë ai ka konsideruar se “është në të mirë të diskutimit”.

4. Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve

- Në fillim të seancës plenare të 20-21 prillit, z. Sabit Rrahmani (Grupi për Integrim/PDAK) e ngriti çështjen e kërkesës së grupit të tij parlamentar për përfshirje në komisionet funksionale. Ai deklaroi se grupi i tij i kishte dorëzuar tri kërkesa të tilla në pesë muajt e fundit dhe se Kryesia ishte përgjigjur në dy të parat duke premtuar se “do t’i shqyrtonte të gjitha mundësitë” për përfshirjen e deputetëve të Grupit për Integrim në komisione. Z. Rrahmani vazhdoi duke thënë se pas kërkesës së fundit, Kryesia ka propozuar që Grupi për Integrim mund të ketë vende në komisione por vetëm si vëzhgues apo në marrëveshje me Grupin 6+ t’i ndajnë vendet, të cilat i ishin ndarë Grupit 6+ që nga fillimi i mandatit. Z. Rrahmani komentoi se zgjidhja e ofruar nga Kryesia paraqiste shkelje të rëndë të nenit 9.1.19 të Kornizës Kushtetuese. Si përgjigje ndaj deklaratës së bërë gjatë seancës paraprake se pesë nga gjashtë deputetët e Grupit për Integrim janë të kyçur në komisione, Z. Rrahmani tha se vetëm katër prej tyre janë të kyçur në një komision – në Komisionin për të drejtat dhe interesat e komuniteteve - në të cilin ata përfaqësojnë *komunitetet e tyre e jo grupin e tyre parlamentar*. Ai shtoi se deputeti i pestë z. Ferid Agani asnjëherë nuk ka qenë anëtar i ndonjë komisioni të Kuvendit¹¹. Znj. Teuta Sahatqija (ORA) deklaroi se grupi i saj parlamentar e mbështeste kërkesën e Grupit për Integrim, duke pohuar se çdo grup parlamentar ka të drejtë të marrë pjesë plotësisht në komisionet e Kuvendit. Z. Džezair Murati (6+/Vakat) deklaroi se grupi i tij parlamentar ishte kategorikisht kundër heqjes dorë nga disa vendet e tyre në favor të Grupit për Integrim. Z. Murati theksoi se grupi i tij parlamentar përbëhej nga përfaqësues të pakicave etnike dhe nuk “ishte zgjidhje” të barten vendet nga pakicat etnike në një grup parlamentar që pjesërisht përbëhet nga përfaqësues shqiptarë të Kosovës. Kryesia vazhdon ta shqyrtojë këtë çështje.¹² *Pohimi, i bërë gjatë seancës plenare të 6 prillit¹³, se Grupi për Integrim tashmë mban disa vende në komisione nuk bën dallimin në mes të Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe komisioneve funksionale të Kuvendit. Aktualisht, katër deputetë të Grupit për Integrim janë anëtarë të një komisioni të Kuvendit – të Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Përbërja e Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve përcaktohet nga Korniza Kushtetuese dhe bazohet në komunitetin etnik e jo në përkatësinë politike. Për më tepër, mandati parësor i komisionit është të shqyrtojë projektligjet dhe punën e Qeverisë nga aspekti i implikimeve në komunitetet etnike. Asnjëri nga deputetët e Grupit për Integrim nuk i takojnë ndonjërit prej komisioneve funksionale të Kuvendit, edhe pse neni 9.1.19 i Kornizës Kushtetuese kërkon që “anëtarësia e të gjitha komisioneve funksionale reflekton shumëllojshmërinë e*

¹⁰ Rregulla 25. 6-9: “Përfaqësuesi i autorizuar i parashtruesve të interpelancës në fillim të debatit ka të drejtë ta arsyetojë atë në lidhje me kërkesën. Kryeministri ose ministri të cilit i parashtrohet interpelanca ka për detyrë ta paraqes dhe të arsyetojë qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjen e shtruar të interpelancës. Deputetët kanë të drejtë të diskutojnë lidhur me çështjen e shtruar në interpelancë në pajtim me dispozitat e Rregullores së punës. Debati lidhur me interpelancën përfundon me miratimin ose me refuzimin e projekt konkluzioneve që i ka propozuar deputeti që ka parashtruar interpelancën.

¹¹ AAK-ja i ka ofruar Partisë së Drejtësisë (PD) vendin e saj në Komisionin për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor, por z. Ferid Agani ka zgjedhur që të mos i bashkohet këtij komisioni duke shpresuar t’i bashkohet ndonjë komisioni më përkatës me fushën e tij të ekspertizës.

¹² Kryesia ka arritur një marrëveshje me grupet parlamentare për këtë çështje pas përfundimit të periudhës raportuese, andaj kjo do të mbulohet në raportin e radhës.

¹³ Shiko raportin 02/2006 e Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

deputetëve të Kuvendit.” Përfaqësuesve të Grupit për Integrim duhet t’u mundësohet anëtarësimi i plotë në komisionet funksionale të Kuvendit, në pajtim me Kornizën Kushtetuese.

5. Qasja

Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancat plenare, në mbledhjet e rregullta të Kryesisë, si dhe në të gjitha komisionet. Shtylla e III-të (OSBE) gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

6. Transparenca

Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka siguruar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka web faqen (www.kuvendikosoves.org, www.skupstinakosova.org, www.assemblyofkosovo.org). që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

FUND.